

ANEKSI 3

Programi buxhetor për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale në Fondin Shqiptar të Zhvillimit

1. Fondet për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale, të parashikuara si program buxhetor në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, janë një mekanizëm financiar që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe vendor. Autoriteti programues, kontraktues dhe zbatues është Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
2. Specifikimet, rregullat, kriteret për financimin e projekteve si dhe shpërndarja e Fondit për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale për financimim e projekteve të reja miratohen nga Këshilli Drejtues i Fondit Shqiptar të Zhvillimit.
3. Fondi Shqiptar i Zhvillimit administron nevojat dhe propozimet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, qendrore dhe aktorë të tjerë (përfshirë FSHZH dhe njësitë e zhvillimit rajonal të tij) që konsistojnë në projekte në interes dhe në funksion të zhvillimit lokal e rajonal, përfshirë edhe projekte zhvillimore me natyrë ekonomike, të zbatuara në partneritet midis FSHZH dhe njësive të vetëqeverisjes vendore dhe subjekte të tjera.
4. Rregulla të hollësishme lidhur me funksionimin e të gjithë procesit të programimit, monitorimit dhe raportimit të ecurisë së zbatimit miratohen me vendim të Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar.
5. Nga fondi për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale, Fondi Shqiptar i Zhvillimit me përparësi duhet të financojë projektet e investimeve në proces me burim financimi ish-Fondin e Zhvillimit të Rajoneve-Infrastrukura Vendore dhe Rajonale. Pjesa e financimit të projekteve në proces vendoset në listën e investimeve të FSHZH-së, në përputhje me ecurinë e projektit. Fondi Shqiptar i Zhvillimit mund të kërkojë rialokime midis projekteve, sipas procedurave të miratuara për investimet publike.
6. Fondi Shqiptar i Zhvillimit, brenda vitit 2023, përmbyll procesin e financimit të projekteve të pa financuara nga ish-Fondi i Zhvillimit të Rajoneve (Infrastrukura Vendore dhe Rajonale). Për këtë ai rakordon me të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe financon ato projekte që kanë dokumentacion të rregullt ligjor. Të gjitha projektet e tjera që nuk përmbushin kriteret ligjore u kthehen njësive të vetëqeverisjes vendore, duke argumentuar arsyet e kthimit të tyre.